



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË TURIZIMIT 2018-2022

I.

MIRATOHET Vendimi për Strategjinë e zhvillimit të turizmit për periudhën 2018-2022 në komunën e Prishtinës.

II.

Strategjia e zhvillimit të turizmit, si në pikën I, ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit, që i definon orientimet zhvillimore të këtij sektori. Përmes kësaj strategjie synohet që të nxitet ardhja e më shumë vizitorëve, si dhe të përmirësohet përvoja e tyre, duke iu ofruar shërbime cilësore turistike.

III.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia e hartuar nga Drejtoria e Kulturës, me ndihmën e akterëve të turizmit.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0293099/18, më 13.12.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>